



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

Prot. 237

Tiranë, 24 mars 2022

Vendim nr. 13, datë 23 mars 2022

**Për organizimin e veprimtarive shkencore dhe jubilarë në nderim të 50-vjetorit të mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit për njësimin e gjuhës shqipe**

Referuar vendimit nr. 10, datë 25 shkurt 2022 të Asamblesë për miratimin programit të veprimtarisë së Akademisë së Shkencave për vitin 2022, Kryesia, në mbledhjen e saj të datës 23 mars 2022,

Vendosi:

1. Në nderim të 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit të zhvillohen veprimtari shkencore e jubilarë në nivel të Akademisë, të SSHSHA, të komisioneve të përhershme e të njëjësive të kërkim-studimit pranë saj.
2. Për përgatitjen e konferencës jubilarë që do të zhvillohet në Tiranë më 10 nëntor 2022 kushtuar kësaj ngjarjeje, përbërja e komitetit organizues të ketë përbërjen në vijim: akad. Shaban Sinani, akad. Ethem Likaj, prof. Seit Mansaku, prof. Valter Memisha.
3. Në konferencën jubilarë që do të mbahet në Tiranë më 10 nëntor 2022 të ftohen për të marrë pjesë të gjithë nënshkruesit e Rezolutës së Kongresit të Drejtshkrimit; përfaqësues të tjerë të rëndësishëm të botës intelektuale: shkrimtarë e studiues nga mbarë hapësira shqipfolëse, me rol të njohur në përrurimin e vlerave shprehëse të shqipes së njësuar në funksione publike; si dhe albanologë të huaj që kanë kontribute origjinale për trajtimin shkencor të historisë së njësimin të shqipes së shkruar.
4. Për konferencën shkencore që do të organizohet në Prishtinë më 17/21 nëntor 2022 për gjuhën e njësuar shqipe caktohen si anëtarë të

komitetit shkencor-organizues akad. Ethem Likaj, akad. emeritus Gjovalin Shkurtaj dhe akad. asoc. Kristina Jorgaqi.

5. Këshilli Ndërakademik për Gjuhën Shqipe, në kuadër të kësaj ngjarjeje jubilarë, të veprojë si organizëm përrurues për vlerat shprehëse të gjuhës shqipe të njësuar.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: komiteti organizues, koordinatorët, sekretari shkencor dhe kancelari.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

